

STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“GES - AGRO” sh.p.k

KREU I

Themelimi – Emri – Objekti – Kohezgjatja - Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Krijimi

Duke u bazuar ne: Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise, ne ligjin nr. 7512 dt.10.08.1991 “Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire dhe privatizimit,” ne nenin 11 te ligjit nr.9901 date 14.04.2008” Per shoqerite tregtare dhe ne ligjin nr. 9723, date 3.5.2007 per Q.K.B me vullnetin e tij te lire per te shprehur dhe ne nenshkrimin e ketij statuti :

1. Sot me date 06/10/2021, ne themeluesit, kemi krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin: **“GES - AGRO ”shpk.**
2. Themeluesit e shoqerise jane :
 - **Z. Antonino Erbusto**, lindur me 07.02.1981, ne Vico Equense, Napoli, Itali me Nr. Karte Identiteti CA33751IE dhe banues Via Casa Lauro,N.13 Piano di Sorrento,Napoli,Itali .

Dhe

- **Z. Giuseppe Spinoso**, lindur me 17.09.1958, ne Marano di Napoli, Napoli, Itali me Nr. Karte Identiteti CA53805IK dhe banues ne Corso Europa,N.22 Marano di Napoli,Itali.

Neni 2

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise

Aktiviteti qe karakterizon objektin e shoqerise eshte si me poshte:

Import- eksport e tregtim me shumicë dhe pakicë të mallrave të ndryshëm ushqimorë dhe Industrialë, Vajrave te ndryshem ushqimore të përdorimit të gjërë brenda dhe jashtë vendit, si ushqime të ndyshme si dhe pije të ndryshme alkoolike dhe jo alkolike, pajisje elektrorashtëpiake, hidrosanitare, materiale ndërtimi dhe elektrike, plastike, polimeri, hekur e celik, pigmentë e bojra të llojave të ndryshme, infomatike, artikuj mobilerie për mobilime zyrash, makina e makineri të rënda, autovetura e goma, motocikleta si dhe pjesë këmbimi të tyre, konfeksione tekstile, detergjente të llojeve të ndryshme, parfumeri, kancelarie, varka e motobarka. Artikujve të ndryshëm të reja dhe të përdorur si rroba, këpucë, orendi shtëpiake, bizhuteri, etj. Investitor në ndërtim. Ndërtimin, investimin, rikonstruksionin e godinave civile, industriale, turistike, bujqësore, ujësjellësave e kanalizime, rrugëve, veprave të ndryshme të artit në fushën e ndërtimit etj. Shërbime në ndërtim; Punime duralumini, hekuri e gipsi.etj, Prodhimin e konfeksioneve

tekstile, plastike, lekure, hekuri, elektronike me material porositësi (Fasonist) etj. Ajo mund të ushtrojë cdo aktivitet industrial tjetër të dobishëm të favorizimit dhe sigurimit të një mbarëvajtje të rregullt të prodhimit dhe mund të kryejë në përgjithësi të gjitha veprimet industriale, tregtarë, financiare, transferimin e pasurive të paluajtshme të lidhura me aktivitetin e shoqërisë. Hapjen e agjensive imobiliare për shitblerje dhe dhënie me qira të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme brenda dhe jashtë vendit. Transport kombëtar dhe ndërkombëtar mallrash dhe udhëtarësh. Hapjen e agjensisë konsulencë dhe investime brenda dhe jashtë vendit si dhe cdo aktivitet tjetër që nuk kërkon licensë të posacme. Hapje e dhomave frigoriferike për konservimin dhe tregtimin e fruta perimeve. Hoteleri e Agro-turizëm. Prodhime bujqësore e blegtoriale, pemtari e vreshtari, sera të thjeshta apo me ngrohje qëndrore. Në përgjithësi të gjitha aktivitetet industriale, tregtarë, financiare, civilc, të luajtshme dhe të paluajtshme që mund të lidhen direkt ose indirekt me objektin e shoqërisë ose me objekt të ngjashëm ose të përafërt me të, etj. Per kete shoqeria mund te punoje si per vehte dhe per te tretet:

Shoqeria mbi te gjitha mund te kryeje cfareolloj veprimi mobiljar, tregtar, financier dhe kreditimi, qeradhenje, hipotekor, te dobishem ose te nevojshem per arritjen e objektit te shoqerise, por vetem per kete perfundim.

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitet juridik pasi te jete regjistruar prane QKB, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara ne ligj. Shoqeria “GES - AGRO” sh.p.k eshte nje shoqeri tregtare me perqejjesi te kufizuar.

Neni 3

Selia

1. Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: Durres,Nr. Pasurie 19/24,Vol.17,Fq.155 Zona Kadastrale Nr.3852, Xhafzotaj,Durres, Shqiperi.
2. Shoqeria ka te drejte te hape dhe te mbylle dege, filiale, agjenci dhe zyra perfaqesuese ne vende te tjera te Shqiperise dhe jashte saj, ose te ndryshoje adresen (rrugen, numrin) e selise qendrore brenda dhe jashte territorit te Shqiperise.
3. Vendbanimi i ortakeve dhe organeve drejtuese, per marredheniet e tyre me shoqerine eshte ai qe rezulton nga regjistri i ortakeve, eshte detyre e ortakeve dhe te anetareve te organeve drejtuese, ti komunikojne shoqerise, me qellim transkriptimin ne regjistrin e ortakeve, edhe numrin e telefonit-it dhe adresen e postes elektronike, keshtu qe mund te perdoren ne funksion te tyre si forma komunikimi.

Neni 4 - Kohezgjatja e shoqerise

Kohezgjatja e shoqerise fillon me regjistrimin e saj juridik dhe fiskal ne QKB, regjistrin tregtar dhe do te vazhdoje pa afat, me perjashtim kur asambleja e ortakeve parashikon ndryshe.

Kreu II

Kapitali

Neni 5 - Kapitali Themeltar

1. Kapitali themeltar i shoqerise "GES - AGRO "shpk do te jete 100.000 (njeqindmije) leke ndare ne(2) dy kuota.

Ortaku themelues **Antonino Erbusto** zoteron (1) nje kuote me vlore te per gjithshme 50.000 (pesedhjete mijë) leke qe perben 50% (pesedhjete) te kapitalit te shoqerise, e derdhur ne arke.

Dhe

Ortaku themelues **Giuseppe Spinosa** zoteron (1) nje kuote me vlore te per gjithshme 50.000 (pesedhjete mijë) leke qe perben 50% (pesedhjete) te kapitalit te shoqerise, e derdhur ne arke.

Kontributet e ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme ose te paluajtshme apo te drejta). Ortaku per gjigjet per humbjen e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 6 - Zmadhim dhe zvogelim i kapitalit

1. Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet neneshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontribute vetem ne para.
2. Ortaket mund te kryejne, me kerkese te Asamblese se Pergjithshme te ortakeve, financime, edhe jo ne proporcjon te pjesmarres perkatese me kapitalin e shoqerise, pa detyrim kthimi ose me detyrim kthimi, me pagese ose pa pagese, ne respekt te kushteve e te limiteve te percaktuara nga ligji per mbledhjen e te ardhurave.
3. Ne asnjë rast shumica nuk mund te detyroje një ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.
4. Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.
5. Ne te gjitha rastet ,zvogelimi prek ortaket ne te njeften mase ndaj pjeses se kapitalit qe perfaqersojne.

Neni 7- Transferimi i kapitalit

1. Kuotat trasferohen lirisht midis ortakeve.
2. Transferimi i pjeseve te kapitalit tek te tretet jane objekt i te Drejtes se Parablerjes ne favor te Ortakeve te tjere, te cilet mund ta ushtrojne kete te drejte sipas procedurave te specifikuara ne nenet e meposhteme:

3. Ne rast se nje ortak (Ofruesi) kerkon te shese dhe /ose te trasferoje disa ose te gjitha kuotat e tij tek nje pale e trete, ortaket e mebtur (Ortaket e Mbetur) kane te drejten e parablerjes ne lidhje me Kuotat e propozuara per transferim (Kuotat e Ofruara) sipas termave dhe kushteve te meposhtem:
 - a. Ofruesi do t'u dergoje fillimisht njoftimin me shkrim ortakeve te mbetur duke percaktuar numrin dhe cmimin e Kuotave te Ofruara, ne kushtet e tjera material te trasferimit (OFERTA), duke ftuar se pari Ortaket e Mbetur per blerjen e ketyre kuotave.
 - b. Ortaket e Mbetur kane te drejte te blejne kuotat e Ofruara sipas kushteve te Ofertes me ane te nje njoftimi me shkrim drejtuar Ofruesit, brenda nje afati prej 30(tridhjete) ditesh pas marrjes se njoftimit te Ofruesit.
4. Ne rast se Ortaku i Mbetur ka refuzuar blerjen e Kuotave te Ofruara ose nuk eshte perjigjur ne lidhje me blerjen e tyre sipas kushteve te percaktuara ne Oferte, Ofruesi ka te drejten ti transferoje Kuotat e Ofruara nje pale te trete sipas kushteve te Ofertes Fillestare. Cdo transferim i Kuotave te Ofruara tek nje pale e trete me kushte te tjera nga ato te Ofertes Fillestare eshte absolutisht i pavlefshem dhe nuk sjell asnje efekt.
5. Ne rast se Ortaku i mbetur blen kuotat e ofruara, ky trasferim do te kryhet ne perputhje me kushtet e Ofertes, pavec ne rast te nje parreveshjeje tjeter midis paleve.
6. Ne rast se ortaku i Mbetur nuk blen kuotat e ofruara brenda nje afati 30 ditor duke filluar nga njoftimi i tij ne perputhje me nenin 7.4 atehere Ofruesi ka te drejten ti transferoje Kuotat e Ofruara nje pale te trete sipas kushteve te Ofertes Fillestare.
7. Ceshtjet e mesiperme nuk do te zbatohen per trasferimin nga nje ortak tek nje shoqeri e kontrolluar prej tij (te pakten ne masen 51% te kapitalit) ose nje transferim nga nje Ortak tek nje parardhes apo pasardhes te drejte per te drejten te tij, apo tek bashkeshorti/ja.
8. Te gjitha njoftimet e percaktuara ne kete nen duhet ti adresohen shoquerise.
9. Cdo trasferim apo zoterim i kuotave, ashtu si dhe krijimi apo trasferimi i cdo te drejte mbi to, duhet te regjistrohen ne registrin e Oratkeve dhe ne QKB.

Kreu III - Organet vendimarrese dhe drejtuese

Neni 8 - Organi Vendimmarres

1. Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimarres i shoquerise.
2. Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimarres i shoquerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteteve te percaktuara ne ligj.
3. Asambleja e per gjithsme e Ortakeve eshte per gjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise
 - b) Ndryshimin e statusit
 - c) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
 - d) Emerimin dhe shkarkimin e likuidueseve dhe te ekperteve kontabel te autorizuar.
 - e) Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c, d , te kesaj pike.
 - f) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave nga administratori, perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raportuese te ecurise se veprimtarise.
 - g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
 - h) Zmadhimin dhe zvoglimin e kapitalit
 - i) Pjesetimin e kuotave dhe anullimin e tyre
 - j) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe procedime te tjera ndaj Administratorit
 - k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
 - l) Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjes se asamblese se perjithshme.
 - m) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti i shoqerise.
4. Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e perjithshme, ne baze te nje autorizimi me shkrim nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete dhe ky i autorizuar me shkrim nga ortaku.
 5. Administratoret e shoqerise nuk mund te veprojne si perfaquesues te ortakeve ne asamblene e perjithshme me autorizim te ortakeve qe mbulojne 70% te quotave te shoqerise.
 6. Autorizimi mund te jete vetem per nje mbledhje te asamblese se perjithshme e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite

Neni 9 – Menyrat e thirrjes se mbledhjes se asamblese se perjithshme

1. Asambleja e perjithshme thirret nga Administratoret sa here qe eshte e nevojshme per interesat e Shoqerise dhe sa here kerkohet nga ligji.
2. Asambleja e perjithshme thirret vetem nepermjet nje njofthimi me poste elektronike derguar ortakeve, ne adresen elektronike te percaktuar ne regjistrin e ortakeve te pakten 20 (njezete) dite perpara dites se percaktuar te mbledhjes.
3. Kur asambleja e perjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 9.2 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord per te marre vendim, pavaresisht parregullesise se mbledhjes.

Neni 10-Kuorumi

1. Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice se zakonshme, asambleja e perjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjesë ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se 70%(shtatedhjete) te kuotave.
2. Ne rastin kur asambleja e perjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit “ per shoqerite Tregtare dhe Shoqerite Tregtare” te ndryshuar, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votive jane te pranishem personalisht,

- votojne me shkresë apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.
3. Nese asambleja e per gjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungesës se kuorumi te permendor me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite me te njejtin rend dite.

Neni 11 – Marrja e Vendimeve

1. Asambleja e per gjithshme vendos me 70% (shtatedhjete) te votave zoteruese te kapitalit te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
2. Asambleja e per gjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshje te tjera si:
 - a. Percaktimin e politikave tregtare, planeve te biznesit dhe buxheti
 - b. Emertimin dhe shkarkimin e Administratorit (eve)
 - c. Emertimin dhe shkarkimin e Eksperteve Kontabeli dhe likuiduesve.
 - d. Percaktimin e shperblimeve.
 - e. Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
 - f. Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
 - g. Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.
3. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane Qendres Kombetare te Biznesit per te pasqyruar ndyshimet ne Ekstraktin Historik te shoqerise.

Neni 12 – Perjashtimi nga e drejta e votave

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e per gjithsme merr vendim per:

- a. Vleresimin e veprimtarise se tij.
- b. Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij.
- c. Ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria.
- d. Dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

13. Administrimi

1. Asambleja e per gjithshme emeron nje ose me shume persona fizik si administratore te shoqerose. Afati i emerimit eshte 5 (pese) vjet, me te drejte riparteritje. Emerimi i Administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit QKB.
2. Administratori i Shoqerise emerohet Z. Antonino Erbusto ,per nje 5 (pese) vjet me te drejte riparteritje.
3. Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji nuk mund te emerohen si administratore te nje shopqerie te kontrolluar e anasjelltas. Cdo emerim i bere ne kundershtim me keto dispozita eshte i pavlefshem.
4. Personi i me poshtem caktohet si administrator i pare i shoqerise per nje periudhe 5(pese) vjecare duke filluar nga data themelimit te shoqerise.

Te dhenat e identifikimit te Administratorit

Z. Antonino Erbusto, lindur me 07.02.1981, ne Vico Equense, Napoli, Itali me Nr. Karte Identiteti CA33751IE dhe banues Via Casa Lauro,N.13 Piano di Sorrento,Napoli,Itali .

Neni 14 Kompetencat e Administratorit

1. Administratori ka te drejta e detyrime si me poshte:
 - a) Kryerjen e te gjitha veprimeve dhe administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e per gjithshme.
 - b) Perfaqesoje shoqerine tregtare
 - c) Kujdeset per mbajtjen e sakte te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise
 - d) Te nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimve duke i paraqitur keto dokumenta perpara asamblese se per gjithshme per miratim.
 - e) Te kryeje rregjistrimet dhe te dergoje te dhenat e detyrueshme te shoqerise sic parashikohet ne ligjin per QKB
 - f) Raportoje perpara asamblese se per gjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare.
 - g) Te kryeje detyra te percaktuara ne ligj dhe ne statut.
2. Administratori eshte i detyruar te therrase mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme ne rastet kur:
 - a. Sipas Bilancit Vjetor apo raporteve financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim
 - b. Ne rast shitje parciiale ose totale te aktiveve te Shoqerise, sic rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
3. Nese asambleja e per gjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne shoqerine ne menyre te pavarur nga njeri – tjetri konform legjislacionit ne fuqi .
4. Asambleja e per gjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Padite qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 15 – Pergjegjesite e Administratorit

1. Administratori eshte perjegjes individualisht ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate adminitritimit te shoqerise.
2. Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen per ti perballur ne menyre individuale ose solidare sipas rastit pasojat perkatese.
3. Pavec sa eshte parashikuar ne dispozitat e perjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14,15,17,18 tc ligjt "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" te ndryshuar administrastori detyrohet:
 - a. Te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjesdis.
 - b. Te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita.
 - c. Te vleresoje me perjegjesi ceshtjet, per te cilat merret vendim.
 - d. Te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mudshme, te interesave personale me ato te shoqerise.
 - e. Te ushtroje detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem.
4. Administratori gjate kryerjes se detyrave te tij, perjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vlersimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.
5. Nese Administratori vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 dhe 2 te ketij neni, eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerjet e shkeljes, si dhe t'i kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standarteve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata perjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.
6. Ne menyre te vecante, po pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i dembshperbleje shoqerise demet e shkaktuara sipas dispozitave te ligjt ne fuqi "Per tregtaret dhe shoqerite Tregtare" te ndryshuar, kryen veprimet e mesposhtme:
 - a. U kthen ortakeve kontributet e kaptalit ose kontribute te tjera.
 - b. U paguan ortakeve interesa apo dividende
 - c. Shpendan aktivitetin e shoqerise
 - d. Lejon qe shoqeria te vzhdoje veprimtarine tregtare, kur ne baze te gjendjes financiare duhej te parashikoje qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet
 - e. Leshon financime
7. Pavec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.
8. Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire dhe dembshperblimin financiar,nese eshte e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund ti ndaloje ngritjen e kerkesa padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

Kreu IV
Neni 16 Viti finaciar

Viti finaciar fillon nga data e rregjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbyllte me 31 dhjetor te vitit korent. Ne vitet ne vijim fillon me date 01 Janar te cdo viti dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Neni 17 -Ekspertet

1. Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomike tregtare te shoqerise, ate vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet ku ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Kreu V Prishja – Riorganizimi i shoqerise

Neni 18 Prishja dhe likuidimi i shoqerise do te behet ne cdo kohe kur:

1. Shpendarja ose prishja e shoqerise mund te behet kur:
 - a. Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar me themelimin e saj
 - b. Me vendimin e Asamblese se ortakeve
 - c. Me hapjen e procedurave te falimentimit
 - d. Nese nuk ka veprimtari per tre vjet dhe nuk eshte njofshuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit 9723 date 03.05.2007 per Qendren Kombetare te Biznesit.
 - e. Me vendimin e gjykates
2. Ne kete rast asembleja e per gjithshme e ortakeve merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqerise duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper”.
3. Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesisie paguese me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.
4. Likuidimi kryet nga likuiduesi i emeruar nga Ortaket e shoqerise.
5. Nese Asembleja e per gjithshme e ortakeve nuk merr nje vendim per emerimin e likuiduesit brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykates per te caktuar nje likuidues.

Likuiduesi merr persiper te drejtat dhe detyrimet e administratorit nga data e emerimit te tij. Ne fund te procesit te likuidimit, Asamblea e Ortakeve vendos mbi bilancin perfundimtar finanziar dhe mbi mbylljen e procesit te likuidimit. Pas pagimit te likuidatorit, Asamblea e Ortakeve(Ortaku i vetem) mban pjesen e mbetur te kapitalit.

Neni 19 – Riorganizimi i shoqerise ,Bashkimi – Ndaria

1. Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te mbledhjes se per gjithshme te asamblese se ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne pjese IX te ligjit 9901 date 14.04.2012 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” i ndryshuar.

Neni 20 -Baza ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe me dispozitat e legjisacionit shqipetar. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit “ Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare” i ndryshuar,Kodi Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 21 Mosmarrveshjet


Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarrveshje qe mund te linde midis Shoqerise do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Ortaket e shoqerise

“GES - AGRO” sh.p.k


Z. Antonino Erbusto

(Emer, Mbiemer, Firme)



Z. Giuseppe Spinoso

(Emer, Mbiemer, Firme)

A handwritten signature consisting of two stylized, cursive loops forming the letters 'Z' and 'G'.